



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
NJËSIA E PROKURIMIT**

Prrenjas, më 18.09. 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje dru zjarri dhe pelet për shkollat, kopshtet, cerdhet dhe institucionet në varësi të Bashkisë Prrenjas”. Me lote:

Loti 1: Blerje dru zjarri

Loti 2: Blerje pelet

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
03413000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,332,940 (Tetë milionë e treqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzet) lekë pa TVSH dhe 9,999,528 (Nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë me TVSH, i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1 – Blerje dru zjarri:

Fondi limit pa TVSH: 7,827,500 (shtatë milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 9,393,000 (nëntë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë) lekë me TVSH.

Loti 2 – Blerje pelet

Fondi limit: 505,440 (pesëqind e pesë mijë e katërqind e dyzet) lekë pa TVSH dhe 606,528 (gjashtëqind e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë me TVSH.

Vlera limit e kontratës është përcaktuar në zbatim të nenit 76, pika “1”, gërma “b” e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1 – Blerje dru zjarri

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

➤ Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të xhiros vjetore, të lëshuar nga Administrata Tatimore për tre (3) vitet e fundit financiare (2023, 2024 dhe 2025).

- Vlera e xhiros vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **30%** vlerës së fondit limit ***për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron***
- Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në **të paktën një vit** nga periudha e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenin 43, pika 2, gërma c (***në rastin e procedurës së hapur të thjeshtuar neni 55, pika 4***) të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si vijon: Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapacitetit ekonomik dhe financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues. Gjithashtu, gjykohet se përcaktimi i vlerës së xhiros në këtë nivel, jep mundësinë e aksesimit, pjesëmarrjes dhe ofertimit në këtë procedurë edhe të biznesit të vogël dhe të mesëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit Nr. 8438,

datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së **fondit limit të kontratës për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron**, operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë: kontratën e furnizimit ,vërtetim të lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate, dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore. **(ose)**
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vlera dhe vitet e kërkuara janë bazuar në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se :

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf për zbatimin të kontratës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

1 (një) shoferë kamioni;

1 (një) punëtorë ndihmës të thjeshtë.

2.3.2 /1 Për shoferin, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- Leje drejtimi përkatëse sipas kategorisë së mjetit;
- Certifikatë të aftësisë profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

-Për punëtorë ndihmës të thjeshtë duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Nëse punonjësit-shoferë janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur në fazën e ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht Neni 40, pika 5, germa “c”, dhe pika 8.

Vendosja e këtij kushti është bërë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe ka për qëllim të sigurojë që kontrata, objekt i prokurimit publik, të realizohet me **cilësi dhe në kohë**, përmes angazhimit të stafit minimal të nevojshëm dhe të kualifikuar.

Në mbështetje të Nenit 40, pika 8 të VKM Nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, sipas specifikave të objektit që prokurohet, të cilat konsiderohen të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, sipas Nenit 40, pika 5, germa “c”, për të provuar përshtatshmërinë për kryerjen e aktivitetit profesional dhe kapacitetet teknike dhe profesionale, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë:

“Fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

Kërkesa për dokumente si kontrata pune, listëpagesa, dhe dokumentet ligjore të drejtimit dhe aftësisë profesionale, janë elementë të domosdoshëm që dëshmojnë qëndrueshmërinë dhe përgatitjen teknike të stafit, si dhe japin siguri të plotë për realizimin me sukses të kontratës.

Kontrata përfshin gjithashtu edhe transportin dhe shpërndarjen e druve në çdo shkollë përfituese. Për këtë arsye, zbatimi me sukses i kontratës kërkon jo vetëm furnizimin e materialit, por edhe përfshirjen e logjistikës së transportit dhe fuqisë punëtore për ngarkim-shkarkim.

Duke marrë parasysh këtë natyrë të zgjeruar të objektit të kontratës, është përcaktuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë duhet të kenë në dispozicion stafin minimal të mëposhtëm:

- 1 (një) shofer kamioni; Operatori ekonomik do kryej për transportimin dhe shpërndarjen e druve të zjarrit në të gjitha institucionet arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe etj.) që janë në varësi të Bashkisë Prrenjas, sipas planit të shpërndarjes të miratuar nga autoriteti kontraktor. (Nga pika e grumbullimit deri te insitucionet/shkollat ne distancen me te larget dhe terrenet e veshtira)
- 1 (një) punëtor ndihmës i thjeshtë.(per ngarkimin dhe shkarkimin e druve neper institucionet arsimore)

Për shoferët, në mënyrë që të garantohet kualifikimi dhe aftësia për operimin me mjetet përkatëse, është kërkuar gjithashtu:

- **Kontratë pune e vlefshme;**
- **Leje drejtimi** sipas kategorisë së mjetit që do të përdoret;
- **Certifikatë të aftësisë profesionale / Patentë manovrimi** nga DPSHTRR.

Ky kriter është vendosur mbi bazën e:

- **Vlerës së kontratës;**
- **Natyrës së zgjeruar të objektit të saj (blerje + transport në çdo shkollë);**
- **Kohëzgjatjes së zbatimit;**
- Dhe përvojës së mëparshme të Autoritetit Kontraktor në kontrata të ngjashme, ku mungesa e fuqisë punëtore ka ndikuar negativisht në përmbushjen e detyrimeve.

Kjo kërkesë është **proporcionale** dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për prokurimin publik, duke garantuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që kanë mundësinë reale për zbatimin korrekt të kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik/ ing pyjesh , të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe certifikaten nga Ministria e Mjedisit, si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave sipas VKM 284 date 29.04.2022 , si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur në fazën e ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion të vlefshëm që vërteton origjinën e mallit që do të ofrohet (drutë e zjarrit), përmes njërës nga alternativat më poshtë:

a. Kontratë të vlefshme dhe aktive për shfrytëzimin/blerjen e lëndës drusore, të lidhur me bashkit, e cila ka kompetencë për administrimin e fondit pyjor dhe shfrytëzimin e tij. ose

b. Në rast se mallin e importon nga jashtë Shqipërisë: Operatori duhet të paraqesë: Deklaratë doganore për importin e mallit, që përmban: (Emërtimin e mallit (lënda drusore), Sasinë, Vendin e origjinës, të dhënat e transportit dhe hyrjes në territorin Shqiptar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Referuar Ligjit Nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet” I ndryshuar,.

2.3.5 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

LISTA E MAKINERIVE				
Nr	EMERTIMI	NJESIA	NUMRI	STATUSI
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 7 ton	cope	1	Pronesi ose Qera

a)Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qira (e vlefshme).

•Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

•Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Makinerite e kerkuara jane te nevojshme per transportimin e druve te zjarrit ne destinacionet e kerkuara ,perkatesisht kamionet do te perdoren per transportin e mallit ne rruge te veshtira dhe ne distancat e largeta nga qendra e Bashkise ndersa kamioncina do te beje transportin e druve ne institucionet me te aferta te Bashkise .

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor per realizimin e kontrates .

Duke marrë parasysh këtë natyrë të objektit të kontratës, është përcaktuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë duhet të kenë në dispozicion mjete e mëposhtëm:

- 1 (një) Kamion me kapacitet mbajtes mbi 7 ton ; është i nevojshëm për arsye se operatori ekonomik do kryej për transportimin dhe shpërndarjen e druve të zjarrit në të gjitha institucionet arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe etj.) që janë në varësi të Bashkisë Prrenjas, sipas planit të shpërndarjes të miratuar nga autoriteti kontraktor. (Nga pika e grumbullimit deri te insitutcionet/shkollat ne distancen me te larget dhe terrenet e veshtira)

Shënim: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), mbajmë në konsideratë përcaktimet e Nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku për procedurat e prokurimit me një fazë parashikohet që: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, ”d”, “dh”, “e”, “h”, ”i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2 – Blerje pelet

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

➤ Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të xhiros vjetore, të lëshuar nga Administrata Tatimore për tre (3) vitet e fundit financiare (2023, 2024 dhe 2025).

- Vlera e xhiros vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **30%** vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron.
- Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në **të paktën një vit** nga periudha e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenin 43, pika 2, gërma c (***në rastin e procedurës së hapur të thjeshtuar neni 55, pika 4***) të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si vijon: Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapacitetit ekonomik dhe financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues. Gjithashtu, gjykohet se përcaktimi i vlerës së xhiros në këtë nivel, jep mundësinë e aksesimit, pjesëmarrjes dhe ofertimit në këtë procedurë edhe të biznesit të vogël dhe të mesëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe Nenin 44, pika 1, parapraf b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i

ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së **së fondit limit te kontrates/** për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron, për të cilën konkurron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

a).Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë: kontratën e furnizimit ,vërtetim të lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate, dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasisë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore. **(ose)**

b)Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasisë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Regullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vlera dhe vitet e kerkuara jane bazuar në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Regullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se :

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf për zbatimin të kontrates, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

1 (një) shofer kamionçine;

1 (një)punëtorë ndihmës të thjeshtë.

2.3.2 /1 Për shoferë, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës (të vlefshme);
-

- Leje drejtimi përkatëse sipas kategorisë së mjetit;
- Certifikatë të aftësisë profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

-Për punëtorë ndihmës të thjeshtë duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Nëse punonjësit-shoferë janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur në fazën e ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht Neni 40, pika 5, germa “c”, dhe pika 8.

Vendosja e këtij kushti është bërë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe ka për qëllim të sigurojë që kontrata, objekt i prokurimit publik, të realizohet me **cilësi dhe në kohë**, përmes angazhimit të stafit minimal të nevojshëm dhe të kualifikuar.

Në mbështetje të Nenit 40, pika 8 të VKM Nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, sipas specifikave të objektit që prokurohet, të cilat konsiderohen të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, sipas Nenit 40, pika 5, germa “c”, për të provuar përshtatshmërinë për kryerjen e aktivitetit profesional dhe kapacitetet teknike dhe profesionale, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë:

“Fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

Kërkesa për dokumente si kontrata pune, listëpagesa, dhe dokumentet ligjore të drejtimit dhe aftësisë profesionale, janë elementë të domosdoshëm që dëshmojnë qëndrueshmërinë dhe përgatitjen teknike të stafit, si dhe japin siguri të plotë për realizimin me sukses të kontratës.

Kontrata përfshin gjithashtu edhe transportin dhe shpërndarjen e druve në çdo shkollë përfituese. Për këtë arsye, zbatimi me sukses i kontratës kërkon jo vetëm furnizimin e materialit, por edhe përfshirjen e logjistikës së transportit dhe fuqisë punëtore për ngarkim-shkarkim.

Duke marrë parasysh këtë natyrë të zgjeruar të objektit të kontratës, është përcaktuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë duhet të kenë në dispozicion stafin minimal të mëposhtëm:

- **1 (një) shofer kamionçine;**
- **1 (një) punëtor ndihmës i thjeshtë.**

Për shoferët, në mënyrë që të garantohet kualifikimi dhe aftësia për operimin me mjetet përkatëse, është kërkuar gjithashtu:

- **Kontratë pune e vlefshme;**
- **Leje drejtimi** sipas kategorisë së mjetit që do të përdoret;
- **Certifikatë të aftësisë profesionale / Patentë manovrimi** nga DPSHTRR.

Ky kriter është vendosur mbi bazën e:

- **Vlerës së kontratës;**
- **Natyrës së zgjeruar të objektit të saj (blerje + transport në çdo shkollë);**
- **Kohëzgjatjes së zbatimit;**
- Dhe përvojës së mëparshme të Autoritetit Kontraktor në kontrata të ngjashme, ku mungesa e fuqisë punëtore ka ndikuar negativisht në përmbushjen e detyrimeve.

Kjo kërkesë është **proporcionale** dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për prokurimin publik, duke garantuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që kanë mundësinë reale për zbatimin korrekt të kontratës.

2.3.3 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

LISTA E MAKINERIVE				
Nr	EMERTIMI	NJESIA	NUMRI	STATUSI
1	Mjet transporti me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton. (Kamionçine)	cope	1	Pronesi ose Qera

a)Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qira (e vlefshme).

•*Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.*

•*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.*

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Makinerite e kerkuara jane te nevojshme per transportimin e druve te zjarrit ne destinacionet e kerkuara ,perkatesisht kamionet do te perdoren per transportin e mallit ne rruge te veshtira dhe ne distancat e largeta nga qendra e Bashkise ndersa kamioncina do te beje transportin e druve ne institucionet me te aferta te Bashkise .

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor per realizimin e kontrates .

- 1 (një) Mjet transporti me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton. (Kamionçine) është i nevojshëm për arsye se operatori ekonomik do kryej transportimin dhe shpërndarjen e peletit në institucionet arsimore (shkolla, kopshte) që janë në varësi të Bashkisë Prrerjas, sipas planit të shpërndarjes të miratuar nga autoriteti kontraktor. (Nga pika e grumbullimit deri te insitucionet/shkollat përkatëse).

Shënim: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), mbajmë në konsideratë përcaktimet e Nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku për procedurat e prokurimit me një fazë parashikohet që: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, ”d”, “dh”, “e”, “h”, ”i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Shënim: Në zbatim të nenit 36, të LPP-së, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” është i bazazvlefshëm termi “ekuivalentë”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)

2. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)

3. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)
